



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2213 Dt 08.10.2024

Senati i Universitetit "Isa Boletini në Mitrovicë, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Ligjin e Pagave 08/L-196, Rregulloren për të ardhurat e personelit akademik, shtesat për funksione dhe kompensimet tjera në UIBM nr.prot.1704 dt.01.08.2024, pastaj Statutin e Universitetit dhe Rregulloren nr. 1670, dt.28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 26.09.2024, vendosi të:

**Shpall
KONKURS**

Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, për vitin akademik 2024/2025

I. Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një mësimdhënës për lëndët: Teknika e shpim-plasjes në miniera, Plasjet speciale dhe masive, Projektimi në shfrytëzim sipërfaqësor;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Makinat Minerare, Transporti në miniera, Menaxhimi i mbetjeve minerare, Mekanika e dherave;
3. Një asistent për lëndët: Kimi, Kimia inorganike, Kimia e përgjithshme;
4. Një asistent për grup lëndësh në Gjeologji;
5. Një asistent për grup lëndësh në Vendburime Minerale;

II. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II;
2. Një asistent për lëndët: Gjuha gjermane I dhe Gjuha gjermane II,
3. Një asistent për lëndën: Matematika I;
4. Një asistent për lëndët: Bazat e informatikës dhe Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore;
5. Një asistent për lëndët: Mikrobiologjia, Biokimia e përgjithshme, Mikrobiologjia e ushqimit, Bazat e toksikologjisë, Toksikologjia e mjedisit, Fiziologjia e mikroorganizmave industrial, Toksikologjia e ushqimit, Kinetika e proceseve bioteknologjike, Kimia dhe teknologjia e drithërave
6. Një asistent për lëndët: Materialet me prejardhje shtazore, Bazat e Inxhinierisë së reaktorëve, Kontrollimi i cilësisë së ushqimit, Shkenca e ushqimit I, Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore, Teknologjia e verës, Inxhinieria ushqimore, Teknologjia e përpunimit të mishit dhe vezëve.
7. Një asistent për lëndët: Kimia e mjedisit, Energjia dhe mjedisi, Burimet alternative të energjisë, Menaxhimi i hedhurinave, Inxhinieria e mbrojtjes së mjedisit, Proceset e riqarkullimit, Transporti i materieve të rrezikshme;
8. Një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I , Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit, 3. Trajtimi i ajrit të ndotur , Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore , Monitorimi dhe pastrimi i gazeve , Trajtimi i ujërave të zeza II , Korrodimi dhe mjedisi , Ndotjet industriale;

Rr. (St.)Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>, info@umib.net, Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1

III. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

1. Një mësimsdhënës për lëndët: Arkitektura dhe organizimi i kompjuterëve, Menaxhimi i bazës së të dhënave, Mikroprocesorët dhe Mikrokompjuterët, Modelimi dhe simulimi kompjuterik.
2. Një asistent për lëndët: Komponentët elektronike, Arkitektura dhe organizimi i kompjuterëve, Rrjetat kompjuterike, Siguria e Informacionit, Menaxhimi i bazës së të dhënave, Bazat e Inxhinierisë Elektrike, Mikroprocesorët dhe Mikrokompjuterët, Elektronikë Digjitale, Modelimi dhe simulimi kompjuterik;

IV. Fakulteti Ekonomik

1. Një mësimsdhënës për lëndën: Financa ndërkombëtare;
2. Një mësimsdhënës për lëndën: Lidershipi;

V. Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimsdhënës për lëndët: Metodologji e mësimit të matematikës I dhe II.
2. Një mësimsdhënës për lëndën: TIK në arsimin Fillor.
3. Një mësimsdhënës për lëndët: Bazat e arsimit muzikor, Interpretim me instrumente.
4. Një asistent për lëndët: Interpretim me instrumente, Bazat e arsimit muzikor.
5. Një asistent për lëndët: Edukim fizik me metodologji.

VI. Fakultetit i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti Juridik

1. Një asistent për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II.

VII. Procedura e angazhimit sipas konkursit dhe përjashtimet për kategori të caktuara.

Procedura e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime bëhet në mënyrë transparente, përmes shpalljes së konkursit publik.

VIII. Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara me Rregulloren nr. 1670, dt. 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.
2. Në UIBM nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune, apo pagesë në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në UIBM nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program) nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind- fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
4. Për kandidatët e punësuar/angazhuar në ndonjërin prej institucioneve private për arsimin e lartë, njësia akademike rezervon të drejtën të angazhoj ose refuzoj kandidaturat mbështetur në kushtet e akreditimit dhe konkurrencën apo interesat e UIBM.

IX. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata mund të mbajnë deri në **6 (gjashtë)** orë në javë.

2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në **10 (dhjetë)** orë në javë.

X. Kohëzgjatja e kontratës dhe kompensimi

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër ose për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet prej datës 1 tetor- 15 janar, ose 16 shkurt deri më 31 maj të vitit përkatës akademik.
2. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin dimëror prej datës 1 tetor deri më datë 15 janar, ndërsa për semestrin veror prej datës 16 shkurt deri më datë 31 maj të vitit përkatës akademik.
3. Vlera e kompensimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet ne përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat e zyrtarëve publikë dhe Rregulloren për të ardhurat e personelit akademik në UIBM në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.
4. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
5. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për angazhim varësisht prej fondit të orëve që posedojnë. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet. Nënshkrimi i kontratave për angazhim do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve.
6. I angazhuari që ka thirrjen profesor në universitetet publike mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe në studimet master.

XI. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) Kërkesën për aplikim;
 - b) Biografinë (CV);
 - c) Certifikatën e lindjes (jo më e vjetër se 6 muaj);
 - d) Kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara me vulë origjinale te noteri për secilën pozitë që aplikon.
 - e) Kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoratë). Nëse më rastin e aplikimit, kandidati dorëzon vetëm dëshminë e aplikimit për nostrifikim, vendimi për nostrifikimin e diplomës/ave përkatëse të fituar jashtë vendit domosdoshmëri duhet të dorëzohet më së largu 3 (tre) ditë para mbledhjes së Këshillit të Fakultetit, në të cilin vendoset për lëndët përkatëse.
 - f) Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime dhe lektorit duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe master ose kopjet e noterizuara me vulë origjinale te noteri.
 - g) Kandidatët të cilët kanë punuar në institucionet e arsimit të lartë – vendimin për zgjedhjen e fundit,
 - h) Dëshmi për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
 - i) Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie në ndonjë institucion të akredituar të Arsimit të Lartë,
 - j) Dëshmi nga Gjykata jo më të vjetër se 15 ditë, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë.
2. Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara sipas këtij vendimi nuk do të pranohen fare nga administrata e fakulteteve dhe nuk do të shqyrtohen nga komisionet vlerësuese.

XII. E drejta e ankesës

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

2. Komisioni i ankesave i përbërë prej 3 anëtarëve emërohet nga këshilli i fakultetit dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit.
3. Kandidatet e pakënaqur kanë të drejtë ankesë pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 8 ditëve nga dita e publikimit të raportit në ueb faqen e fakultetit përkatës dhe universitetit.
4. Komisioni i ankesave më së largu 3 ditë pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës e dorëzon në Këshill të Fakultetit. Këshilli i Fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendos për miratim ose refuzim të tij.
5. Senati i Universitetit në mbledhjen e parë vendos për miratimin e propozimeve duke përfshirë edhe vendimin lidhur me ankesën të përcjella nga njësitë akademike.
6. Ndaj vendimit të Senatit nga paragrafi 5, kandidatët e pakënaqur mund të hapin konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike, respektivisht nga data **04.10.2024 deri më 18.10.2024**

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Fakultetin përkatës prej orës **08:00-16:00**.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike në adresën elektronike: linku **angazhimi2024-2025@umib.net**.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin publikohet në: www.umib.net.

